

VENDIM
Nr. 817, datë 30.12.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 493, DATË 21.7.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE
NË BASHKINË KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI
ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 493, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë dhe çaktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2025, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 161 122 007,65 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e njëqind e njëzet e dy mijë e shtatë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të 2 (dy) objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimi i kopshtit/çerdhes në fshatin Luz i Vogël, Bashkia Kavajë, në masën 34 658 401 (tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e një) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimi i kopshtit/çerdhes në fshatin Golem, Bashkia Kavajë, në masën 126 463 606,65 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.”.

b) Në pikën 3, togfjalëshi “... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...” zëvendësohet me “... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama